

E DREJTA E VOTËS PËR ZGJEDHËSIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

REZULTATE VËZHGIMI
ZGJEDHJET PARLAMENTARE
25 PRILL 2021

Ky raport është hartuar në kuadrin e projektit “Zgjedhje Gjithëpërfshirëse” të financuar nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Përmbajta dhe pikëpamjet e shprehura janë të autorit.

Tabela e përmbajtjes

	Lista e Figurave.....	4
	Shkurtime	5
I.	Hyrja	6
II.	Përmbledhja Ekzekutive	8
III.	Kuadri ligjor dhe zgjedhësit me Aftësi të Kufizuara.....	10
	3.1 Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.....	10
IV.	Metodologjia	15
	4.1 Pjesëmarrësit	15
	4.2 Instrumentat & Materialet	16
	4.3 Procedura	16
	4.4 Analiza Statistikore	16
	4.5 Etika në realizimin e studimit	16
V.	Pezultate.....	17
VI.	Sondazhi i kryer jashtë qendrave të votimit.....	20
VII.	Konkluzione	22
VIII.	Rekomandime.....	24
IX.	Aneksat - instrumentat.....	26

Lista e Figurave

Figura 1.	Qendrat e vëzhguara sipas qyteteve	15
Figura 2.	Vendosja e qendrave të votimit në nivele të ndryshme katesh.....	17
Figura 3.	Niveli i aksesit në hyrje të qendrave të votimit	18
Figura 4.	Pjesëmarrja në votim e personave me aftësi të kufizuara sipas llojit të aftësisë së kufizuar	18
Figura 5.	Përqindja e votimit në mënyrë të drejtpërdrejtë për kategori të ndryshme të zgjedhësve me aftësi të kufizuara.....	19
Figura 6.	Përqindja e familjeve që kanë persona që nuk kanë mundur të votojnë.....	20

Shkurtimet

AWEN	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
GJEDNJ	Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
INSTAT	Instituti i Statistikave
FSHDPAK	Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
KSHH	Komiteti Shqiptar i Helsinkit
QV	Qendër Votimi
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

I. HYRJJE

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë si edhe Kodi Zgjedhor sanksionojnë të drejtën për të marrë pjesë në proceset zgjedhore si zgjedhës dhe si të zgjedhur, për të gjithë shtetasit, përfshirë këtu edhe zgjedhësit me aftësi të kufizuara.¹ Për zgjedhësit me aftësi të kufizuara kjo e drejtë është e shprehur edhe në Konventën e OKB për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Realizimi i kësaj të drejte është vlerësuar si qëllim strategjik në Planin Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara.² Përmirësimet e Kodit Zgjedhor, që nga viti 2002 e në vijim përmirësuan cilësisht mundësinë e votimit për zgjedhësit me aftësi të kufizuara, duke filluar nga mënyra e votimit vetëm nëpërmjet shoqëruesit, në alternativën për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë në votime për zgjedhësit me aftësi të kufizuara në lëvizje dhe shikim, e duke vijuar më tej me lehtësira në mjete dhe shërbime.

Megjithë këto përmirësime, e drejta zgjedhore e zgjedhësve me aftësi të kufizuara mbetet ende e cënuar për disa arsye kryesore. Së pari, Kodi Zgjedhor i RSH ka parashikuar lehtësira vetëm për zgjedhësit që arrijnë të shkojnë në qendrën e votimit e të votojnë para komisionit zgjedhor, persona me aftësi të kufizuara shqisore dhe fizike, duke lënë të përjashtuar personat me aftësi të kufizuara në sferën e intelektit, të cilët gjithashtu kanë nevojë për mbështetje.

Së dyti, dispozitat ligjore nuk garantojnë në nivelin e duhur sigurimin e aksesueshmërisë në qendrat e votimit për të gjitha llojet e aftësive të kufizuara, duke përfshirë këtu edhe personat me aftësi të kufizuara fizike dhe shqisore

Së treti, përmes mungesës së alternativave të votimit, një grup i madh personash penalizohen, duke mos mundur të shkojnë të votojnë. FSHDPAK, në vijimësi ka tërhequr

1. Përjashtim këtu përbëjnë personat me aftësi të kufizuara, të cilëve u është hequr zotësia për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë, sipas neni 45, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Kodit Zgjedhor, neni 44, pika c.

<https://www.parlament.al/www-content/uploads/2015/10/kushtetuta-perditesuar-1.pdf>

<http://www.cec.org.al/sq-al/kodi-zgjedhor>

2. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 483, datë 29.6.2016 Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara, 2016–2020

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/124-2016.pdf

vëmendjen se ka një numër të konsiderueshëm zgjedhësish me aftësi të kufizuara, të cilëve u mohohet e drejta për votim të barabartë dhe të fshehtë, jo vetëm për shkak të kufizimeve ligjore, por edhe sepse një pjesë prej tyre, për shkak të aftësisë së kufizuar, nuk dalin dot nga shtëpia për të shkuar për të votuar.

Së katërti, parashikimi për heqjen e së drejtës për të votuar, në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i cili pasqyrohet edhe në Kodin Zgjedhor, të personave të cilëve u është hequr zotësia për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë, është një kufizim i cili cënon personat me aftësi të kufizuara mendore. Ky parashikim vjen në kundërshtim me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara si dhe me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Sipas KDPAK, ky parashikim është diskriminues pasi cënon në mënyrë të pajustificuar vetëm grupimin e personave me aftësi të kufizuara mendore. Ndërsa, Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut e cilëson si shkelje të së drejtës për të votuar këtë kufizim të vendosur në mënyrë absolute në ligj, pa marrë parasysh specifikat e secilit rast, sipas një vlerësimi të përshtatshëm. Ky është një nen i cili diskriminon personat me aftësi të kufizuara mendore, të cilëve me vendim gjykatë i është hequr zotësia juridike për të vepruar.

Në zhvillimet e fundit ndërkombëtare, miratimi nga OKB i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në vitin 2006, shënoi një fillim të ndryshimeve në kuadrin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, të cilët fuqizuan më tej kërkesat ndaj qeverive për respektimin dhe përmbushjen e këtyre të drejtave, duke filluar nga të drejtat politike, civile e ato sociale dhe ekonomike. Ratifikimi nga ana e shtetit shqiptar, në Dhjetor 2012, i kësaj Konvente krijon detyrime të reja për qeverinë shqiptare në drejtim të ndryshimeve ligjore dhe praktikave për të mundësuar realisht pjesëmarrjen në votime të të gjithë zgjedhësve me aftësi të kufizuara.

Numri i votueseve me aftësi të kufizuara nuk është zyrtarisht i deklaruar. Megjithatë, duke iu referuar statistikave të marra nga INSTAT mbi grup moshat e popullsisë³ mund të konstatohet se janë afërsisht 134 mijë persona me aftësi të kufizuara në moshë votimi. Nëse llogarisim edhe pjesëtarë të familjeve të personave me aftësi të kufizuara me të drejtë vote, potenciali i tyre për të ndikuar në vendimmarrje përmes mekanizmit të votës rritet disa herë.

3. Censusi i Popullsisë dhe Banesave, 2011

II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri po ndërgjegjësohen gjithnjë e më shumë se pjesëmarrja e tyre në proceset zgjedhore është një mënyrë që ndikon në përshpejtimin e përfshirjes së tyre. Nëpërmjet mekanizmit të votës, ata ndikojnë tek politikëbërësit në hartimin e politikave dhe ligjeve që realisht luajnë rol në përmirësimin e cilësisë së jetesës për ta dhe familjarët e tyre.

Ky raport vëzhgimi synon të sjellë informacion në lidhje me mundësitë reale që kanë personat me aftësi të kufizuara, të të gjitha llojeve, për ta ushtruar të drejtën e votës, si edhe për angazhimin dhe nxitjen e strukturave përgjegjëse për të siguruar lehtësirat e domosdoshme sipas ligjit.

Vëzhgimi u realizua në ditën e votimit për zgjedhjet parlamentare të mbajtura më 25 Prill 2021, në dhjetë bashki, Tiranë, Elbasan, Shkodër, Vlorë, Kamëz, Peshkopë, Sarandë, Pogradec, Korçë, Durrës. U vëzhguan 127 qendra votimi nga 22 vëzhguesit e lëvizshëm të FSHDPAK (12 vëzhgues) dhe AWEN (10 vëzhgues), dy organizata të cilat bashkëpunuan në monitorimin e specifikave që mbulonte secila prej tyre. 50 % e vëzhguesve të ADRF ishin persona me aftësi të kufizuara ose familjarë të tyre.

Rezultatet e vëzhgimit treguan për një ndërgjegjësim të kënaqshëm të komisioneve zgjedhore për të mirëpritur dhe orientuar zgjedhësit me aftësi të kufizuara. Vazhdon të mbetet ende problem mosvendosja e QV në katet e para (përdhe) të ndërtesave, 26.7% e tyre ishin në katet e sipërme. Njësitë e pushtetit vendor ende nuk e kanë zbatuar detyrimin për të caktuar si qendra votimi objekte me hyrje të përshtatur, rreth 48.8% e qendrave të votimit në katet përdhe, ishin në objekte me hyrje me shkallë. Gjatë këtyre zgjedhjeve, 21.3% e qendrave nuk ishin pajisur nga KQZ me dhomë fshehtësie të përshtatur për personat me aftësi të kufizuara. 27.6% e qendrave të vrojtuar nuk ishin të pajisura me fletën e posaçme të votimit, e cila do të siguronte votimin e drejtpërdrejtë të votuesve me vështirësi në shikim. Ndërkohë që vetëm 27.8% e zgjedhësve me aftësi të kufizuara që votuan, ishin identifikuar paraprakisht si të tillë, duke kufizuar kështu vemendjen e njëjësive vendore për të marrë masat lehtësuese.

Mungesa e mjeteve të posaçme të votimit për të verbërit në disa prej qendrave të votimit në të dhjeta qytetet, bëri që 77% e personave të verbër të votonin nëpërmjet

asistentit, duke cënuar kështu parimin e fshehtësisë së votës. Po ashtu, 80.5% e personave me probleme dëgjimi nuk patën ndërmjetësimin e interpretit të gjuhës së shenjave për të patur informacion plotësues gjatë votimit.

Edhe në këto zgjedhje, nuk u respektua procedura e parashikuar në ligj për votimin me asistencë, pasi për më shumë se gjysmën e zgjedhësve që votuan me asistencë, shoqëruesi nuk plotësoi deklaratën në Librin e Protokolleve të mbledhjeve të KQV (52.4%).

76.1%, nga 172 familje, të intervistuar në 22 zona vëzhgimi, konfirmuan se në familjet e tyre kishte të paktën një person me të drejtë vote që nuk mundi të votonte pasi nuk dilte dot nga shtëpia, për shkak të aftësisë së kufizuar të përherëshme apo të përkohëshme ose moshimit.

Rekomandimet, bazuar mbi rezultatet e këtij vëzhgimi, synojnë të orientojnë për përmirësime ligjore dhe zgjidhje administrative mbi ndarjen e përgjegjësive institucionale për të lehtësuar votimin e zgjedhësve me aftësi të kufizuara të të gjitha llojeve si dhe alternativa për zgjedhësit që nuk dalin dot nga shtëpia për të votuar, për shkak të aftësisë së kufizuar dhe mungesës së aksesueshmërisë. Për më tepër, këto rekomandime synojnë të orientojnë për marrjen e masave në drejtim të organizimit të shërbimeve parazgjedhore e zgjedhore për zgjedhësit me aftësi të kufizuara përsa i përket identifikimit të tyre në lista, informimit dhe ndërgjegjësimit të tyre për këtë të drejtë, si dhe gjithashtu mundësimin e transportit të përshtatur për në qendrat e votimit, përzgjedhjen e QV të përshtatura dhe/ose përshtatjen e tyre dhe pajisjen me mjete të posaçme votimi për të verbërit dhe sigurimin e mbështetjes me interpretë të zgjedhësve me aftësi të kufizuar në dëgjim dhe në të folur.

III. KUADRI LIGJOR DHE ZGJEDHESIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Kuadri ligjor, kudo në botë, i sheh shtetasit si të barabartë, për këtë arsye askush nuk duhet të përjashtohet nga procesi zgjedhor. Ligji i ngarkon administrates publike detyrën për t'i ofruar mundësi të barabarta të gjithë zgjedhësve, në ushtrimin e të drejtës së tyre të zgjedhjes.

Në Republikën e Shqipërisë, ligji i siguron të drejtën e zgjedhjes edhe personave me aftësi të kufizuara, e sanksionuar kjo në Kushtetutën⁴ e Republikës së Shqipërisë dhe në Kodin Zgjedhor.

E drejta e votimit të barabartë, të drejtpërdrejtë e të fshehtë për të gjithë shtetasit e Republikës së Shqipërisë është e sanksionuar në:

Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nr. 8417, dt.21.10.1998, neni 45, pika 1, 2 “Çdo shtetas që ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, ka të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet. Përjashtohen nga e drejta e zgjedhjes shtetasit e deklaruar me vendim gjyqësor të formës së prerë si të paaftë mendërisht”.

3.1 Kodi Zgjedhor⁵ i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar

Në Kodin Zgjedhor sanksionohet e drejta e votimit të barabartë, të drejtpërdrejtë e të fshehtë për zgjedhësit me aftësi të kufizuara. Në nenin 108, Zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë, përcaktohet se:

1 Zgjedhësi, që për arsye fizike nuk është në gjendje të kryejë vetë procedurat e votimit, mund të kërkojë ndihmën e një familjari ose zgjedhësi tjetër, që është në listën e zgjedhësve të asaj zone të qendrës së votimit. Të dy zgjedhësit duhet të jenë të pranishëm në qendrën e votimit kur përdoret kjo procedurë.

4. Miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 të Kuvendit Popullor. Miratuar me referendum më 22.11.1998 Shpallur me dekretin nr. 2260, datë 28.11.1998 të Presidentit të Republikës, Rexhep Mejdani Ndryshuar me ligjin nr. 9675, datë 13.1.2007 Ndryshuar me ligjin nr. 9904, datë 21.4.2008 Ndryshuar me ligjin nr. 88/2012, datë 18.09.2012 Ndryshuar me ligjin nr. 137/2015, datë 17.12.2015 Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016; Ndryshuar me ligjin nr. 101/2020.

5. Ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.7.2012 dhe ligjin nr. 31/2015, datë 2.4.2015.

- 2** Një person mund të ndihmojë vetëm një zgjedhës që nuk mund të votojë vetë.
- 3** Para se të shënojë në fletën e votimit, personi që ndihmon një zgjedhës tjetër, bën një deklaratë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së se do të votojë sipas udhëzimeve, se nuk do të ndikojë në vendimin e zgjedhësit, se nuk do të bëjë publike votën dhe se ai vetë nuk ka votuar për llogari të një zgjedhësi tjetër.
- 4** Anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve dhe sekretari nuk mund të ndihmojnë asnjë zgjedhës që nuk mund të votojë vetë.
- 5** Shënimi në fletën e votimit bëhet detyrimisht në dhomën e fshehtë.
- 6** Brenda periudhës së rishikimit të listave të zgjedhësve, zgjedhësit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni kanë të drejtë t'i kërkojnë kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore, që përgatit listën e zgjedhësve të qendrës përkatëse të votimit, regjistrimin e tyre si zgjedhës që nuk mund të votojnë vetë. Kërkesa për regjistrim shoqërohet me dokumentacionin zyrtar që provon llojin dhe kategorinë e paaftësisë. Regjistrimi si zgjedhës që nuk mund të votojë vetë bëhet për të lehtësuar votimin e këtyre zgjedhësve.
- 7** Në çdo rast, kur ka zgjedhës të regjistruar, sipas pikës 6 të këtij neni, të cilët kanë vështirësi hyrjeje në mjedisin e qendrës së votimit, caktimi i qendrës së votimit dhe organizimi i saj bëhen në mënyrë të tillë që të garantojnë hyrjen e lirë për këtë kategori zgjedhësish. Në rast se kjo është e pamundur, në përputhje me udhëzimet dhe me shpenzimet e KQZ-së, kryetarët e njësisë së qeverisjes vendore caktojnë personel apo pajisje ndihmëse për të garantuar hyrjen e lirë.
- 8** Në rastin e zgjedhësve të verbër, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore njofton KQZ-në për numrin e zgjedhësve të verbër dhe qendrat e tyre të votimit. KQZ-ja, në përputhje me procedurat dhe afatet e shpërndarjes së materialeve zgjedhore, pajis komisionet e këtyre qendrave të votimit me mjete të posaçme votimi, të cilat lejojnë zgjedhësit që të lexojnë ose të kuptojnë fletën e votimit dhe të votojnë në mënyrë të pavarur. Zgjedhësi i verbër informohet nga KQV-ja për mënyrën e votimit me mjete të posaçme votimi dhe, me kërkesën e tij, pajiset me to. Në rast të kundërt, zgjedhësi voton në përputhje me pikat 1 dhe 3 të këtij neni.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi Nr. 10 221, datë 04.02.2010, neni 9, 'Pjesëmarrja në politikë' ..., "ndalohe diskriminimi në ushtrimin e së drejtës për të zgjedhur, për t'u zgjedhur dhe për t'u emëruar në një detyrë publike, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji". Ndër shkaqet që mund të përbëjnë diskriminim të nenit 1, të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është dhe aftësia e kufizuar dhe gjendja shëndetësore.

Udhëzimi i KQZ, Nr.01, datë 12.12.2012 “Për mënyrën e ngritjes dhe caktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet”, kërkon që: (a) Kryetari i njësisë së vetqeverisjes vendore, të marrë masa për: ...krijimin e lehtësirëve për votimin e personave me aftësi të kufizuara; (b) QV të jenë në katet e para të objekteve; (c) krijimin e lehtësirave për votimin e personave me aftësi të kufizuar; (d) dërgimin në KQZ të listës së votuesve me aftësi të kufizuar dhe votuesve të verbër brenda periudhës së rishikimit të ekstraktit të përbërësve zgjedhorë.

Vendim i KQZ-së nr. 09, datë 19.01.2021 “Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe sensibilizimit të zgjedhësve, për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021” përcakton se ... programi i edukimit të zgjedhësve ka një vëmendje të veçantë për edukimin dhe informimin e zgjedhësve me aftësi ndryshe, në lidhje me procedurat e votimit.

Vendim Nr. 33 datë 16. 12.2020” Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të Dhomës së Fshehtë që do të përdoret në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, specifikon se...’Për zgjedhësit me aftësi të kufizuara, para dhe tetraplegjikë, modeli i dhomës së fshehtë duhet të jetë i përshtatur për nevojat e tyre. Modeli i dhomës së fshehtë i përshtatur për nevojat e zgjedhësve më aftësi të kufizuara, që i përkasin këtij grupimi, i konsultuar edhe me organizatat e shoqërisë civile, përfaqësues të këtyre personave, i mundëson këtyre zgjedhësve të ushtrjnë vetë të drejtën e votës, duke garantuar fshehtësinë e saj.

Vendim Nr.1, datë 25.03.2021, “Për mënyrën e ngritjes, organizimit, funksionimit të komisionit të qendrës së votimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve në qendrën e votimit”, në nenin 36, për “Zgjedhësit që nuk mund të votojnë vetë” përcakton se: (1) Zgjedhësi, që për arsye fizike nuk është në gjendje të kryejë vetë procedurat e votimit, mund të kërkojë ndihmën e një familjari ose zgjedhësi tjetër, që është në listën e zgjedhësve të asaj QV-je. Të dy zgjedhësit duhet të jenë të pranishëm në qendrën e votimit kur përdoret kjo procedurë.; (2) Kryetari i KQV-së verifikon se personi që do të ndihmojë zgjedhësin që nuk mund të votojë vetë, është në listën e zgjedhësve të asaj QV-je. Verifikimi kryhet në listën e zgjedhësve të QV-së; (3) Një person mund të ndihmojë vetëm një zgjedhës që nuk mund të votojë vetë; (4) Pasi zgjedhësi që kërkon ndihmë për të votuar ka kryer identifikimin elektronik, personi që do ta ndihmojë, para se të shënojë në fletën e votimit, bën një deklaratë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së se do të votojë sipas udhëzimeve, se nuk do të ndikojë në vendimin e zgjedhësit, se nuk do të bëjë publike votën dhe se ai vetë nuk ka votuar për llogari të një zgjedhësi tjetër; (5) Pas kryerjes së procedurave sipas paragrafit 4 të këtij neni, zgjedhësi i shoqëruar nga personi që do ta ndihmojë hyn në dhomën e fshehtë. Shënimi në fletën e votimit

bëhet detyrimisht në dhomën e fshehtë; (6) Anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve dhe sekretari nuk mund të ndihmojnë asnjë zgjedhës që nuk mund të votojë vetë.

Ligj Nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara” dhe Vendimi Nr. 1074, datë 23.12.2015 “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”, kërkojnë gjithashtu heqjen e barrierrave për të garantuar votim të barabartë, të drejtpërdrejtë e të fshehtë për zgjedhësit me aftësi të kufizuara

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, e ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë në Dhjetor 2012, në Nenin 29 ‘Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike’, shprehet se Shtetet Palë duhet t’u garantojnë personave me aftësi të kufizuara të drejtat politike dhe mundësinë për t’i gëzuar ato në baza të barabarta me të tjerët dhe duhet të marrin përsipër: (a) Të sigurojnë se personat me aftësi të kufizuara mund të marrin pjesë në mënyrë të plotë dhe efektive në jetën politike dhe publike, mbi bazë të barabarta me të tjerët, drejtpërsëdrejti apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, përfshirë dhe të drejtën dhe mundësinë për personat me aftësitë kufizuara për të votuar dhe për t’u zgjedhur, ndër të tjera duke: (i) siguruar që procedurat, fasilitetet dhe materialet e votimit janë të përshtatshme, të vlefshme/te arritshme dhe të thjeshta për t’u kuptuar dhe përdorur; (ii) mbrojtur të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për të votuar me votë të fshehtë në zgjedhje dhe referendume publike, pa kërcënim, të kandidojnë për zgjedhje, të punojnë në zyrë në mënyrë efektive dhe të kryejnë të gjitha funksionet publike në të gjitha nivelet e qeverisë, duke lehtësuar përdorimin e teknologjive ndihmëse, kur të jetë e përshtatshme; (iii) garantuar shprehjen e lirë të vullnetit të lirë të personave me aftësi të kufizuara si zgjedhës dhe për këtë qëllim, kur është e nevojshme, me kërkesën e tyre, lejohet asistenca në votim nga një person që zgjidhet prej tyre.

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020, VKM nr. 483, datë 29.6.2016, në fushën e veprimit ‘Pjesëmarrja në jetën politike dhe publike’, përcakton si Objektiv 1 mundësimin e personave me aftësi të kufizuara për të votuar, advokuar për interesat e tyre dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje.

Pas viteve ‘90, kuadri ligjor zgjedhor ka pësuar ndryshime të vazhdueshme. Ndryshime të vazhdueshme janë pasqyruar edhe në Kodin Zgjedhor, pas viteve 2000. Megjithatë edhe pse sollën përmirësime në lidhje me mundësinë e pjesëmarrjes sa më të gjerë të Personave me Aftësi të Kufizuara në një proces votimi të drejtpërdrejtë, të barabartë e të fshehtë duke tentuar drejt standarteve bashkëkohore, përsëri legjislacioni mban të kufizuar numrin e zgjedhësve me aftësi të kufizuara që marrin pjesë në një votim të

fshehtë e të drejtpërdrejtë. Kodi Zgjedhor, neni 108, ende ka mangësi apo paqartësi që ndikojnë në uljen e numrit të PAK në votime:

- ◆ Mungesa e alternativave për zgjedhësit me aftësi të kufizuara të cilët e kanë të pamundur të lëvizin nga qendrat e banimit:
- ◆ Mundësia e votimit jashtë qendrës së votimit (kutia e levizshme etj)
- ◆ Paqartësia për sa i përket aksesit dhe lehtësirave që u ofrohen zgjedhësve me aftësi të kufizuara fizike që mund të lëvizin, që të mund të shkojnë dhe të hyjnë në qendrën e votimit, paqartësi në lidhje me përgjegjësitë dhe koordinimin mes strukturave përgjegjëse, si dhe për mënyrat për realizimin e këtij procesi.
- ◆ Mungesa e një mekanizmi që bën të mundur identifikimin e zgjedhësve me aftësi të kufizuara.
- ◆ Mungesa e aksesit për zgjedhësit me probleme dëgjimi (vendosja në qendrën e votimit ku janë të identifikuar zgjedhës të tillë e përkthyesit të gjuhës së shënjavje).

Kushtetuta, jo në përputhje me standardet ndërkombëtare të fundit, kërkon një ndryshim substancial, që ka të bëjë me nenin 45, pika 2, sipas të cilit: Përrjashtohen nga e drejta e zgjedhjes shtetasit e deklaruar me vendim gjyqësor të formës së prerë si të paafte mendërisht. Ky është një nen, i cili diskriminon personat me aftësi të kufizuara mendore, të cilëve me vendim gjykate u është hequr zotësia juridike për të vepruar. Heqja e së drejtës për të votuar (e interpretuar si për të drejtën për të zgjedhur, ashtu edhe për t'u zgjedhur), përbën diskriminim të drejtpërdrejtë dhe bazohet në një mendësi të vjetruar, që të gjithë personat me aftësi të kufizuara mendore, intelektuale apo me probleme të shëndetit mendor, janë të paafte në disa fusha apo në çdo fushë të jetës, duke përfshirë këtu pjesëmarrjen në jetën politike e proceset zgjedhore. Zotësia juridike për të vepruar nuk përbën më një parakusht për të votuar. Vlen të përmendet ndryshimi i bërë nga Komisioni Europian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), me datë 19 Dhjetor 2011, i Kodit të Praktikave të Mira (për personat me aftësi të kufizuara), ku theksohet: “E drejta universale për të votuar është një parim i Trashëgimisë Europiane të Votimit. Personat me Aftësi të Kufizuara nuk mund të diskriminohen në lidhje me të, në përputhje me nenin 29 të KDPAK dhe me vendimet e GJEDNJ”.


IV. METODOLOGJIA

4.1 Pjesëmarrësit

Procesi i votimit në ditën e zgjedhjeve parlamentare të mbajtura në datën 25 Prill 2021 u vëzhgua specifikisht edhe në lidhje me aksesin që ofronte ky proces për zgjedhësit me aftësi të kufizuara. 127 qendra votimi u vëzhguan nga 22 vëzhgues të lëvizshëm të FSHDPAK dhe AWEN, të cilët sollën informacionin e tyre nga dhjetë bashki dhe respektivisht nga qendrat e votimit në Tiranë (n= 49, 38.6%), në Elbasan (n=6; 4.7%), në Shkodër (n=18, 14.2%), Vlorë (n=19, 15%), Kamëz (n=10, 7.9%), Durrës (n=5, 3.9%), Peshkopi (n=6, 4.7%), Sarandë (n=8, 6.3%), Pogradec (n=4, 3.1%), Korçë (n=2, 1.6%).

172 votues, në 22 qendra të votimit, të përzgjedhura në mënyrë rastësore në Tiranë, Vlorë e Kamëz, u përfshinë në një sondazh që synoi të mbledhë të dhëna mbi familjarë të tyre, të cilët nuk kanë mundur të dalin nga shtëpitë për të votuar, për shkak të një aftësie të kufizuar apo moshimit. Figura 1, tregon qendrat e vëzhguara.

Figura 1. Qendrat e vëzhguara sipas qyteteve



4.2 Instrumentat & Materialet

Për marrjen e informacionit në lidhje me aksesin që ofronte procesi zgjedhor për zgjedhësit me aftësi të kufizuara u përdor një pyetësor specifik, me 13 pyetje të mbyllura, ku vëzhguesit klikuan alternativën që përputhej me situatën gjatë procesit të votimit.

Po ashtu, u përgatit një pyetësor për t'u realizuar jashtë qendrës së votimit, pasi qytetari kishte mbaruar votimin. Pyetjet ishin të mbyllura dhe synonin të merrnin informacion mbi të afërm apo familjarë të votuesve të intervistuar, të cilët nuk mund të merrnin pjesë në votime për shkak të një aftësie të kufizuar të përhershme apo të përkohëshme.

Pyetësorët u përgatitën nga stafi i FSHDPAK.

4.3 Procedura

Të gjithë vëzhguesit u trajnuan paraprakisht para ditës së votimit në një trajnim të realizuar nga KRIIK si edhe një tjetër nga FSHDPAK dhe AWEN. Të dhënat u mbledhën në ditën e votimit, 25 Prill 2021, pas përfundimit të qëndrimit të vëzhguesve në qendrat e votimit, që nga hapja e deri në mbylljen e tyre.

4.4 Analiza Statistikore

Të dhënat e mbledhura përmes pyetësorëve sasiorë u hodhën e më pas u përpunuan përmes programit SPSS. Variablat ishin nominale kryesisht, kështu që u analizuan përqindjet dhe frekuenca. Komentet e vëzhguesve u hodhën dhe u përpunuan në excel.

4.5 Etika në realizimin e studimit


Të gjithë vëzhguesit pranuan me vullnetin e tyre të lirë që të jenë pjesë e procesit të vëzhgimit zgjedhor dhe mbledhjes së të dhënave përmes pyetësorëve. Vëzhguesit u akredituan nga KQZ dhe ata nëshkruan gjithashtu një zotim për të raportuar me saktësi dhe vërtetësi mbi çdo konstatim në ditën e votimit.

V. REZULTATE

Në 127 qendrat e votimit të vëzhguara në bashkitë e Tiranës, Vlorës, Shkodrës, Elbasanit, Korçës, Pogradecit, Peshkopisë, Kamzës, Sarandës, Durrësit rezultoi se pothuajse të gjitha komisionet e votimit mbajtën qëndrim pozitiv ndaj votuesve me aftësi të kufizuara (92.8%). Rezultatet treguan se kishte një përqindje të ulët (7.2%) të rasteve, ku ndaj zgjedhësve me aftësi të kufizuara ishte mbajtur një qëndrim i më fyes e indiferent (n=8).


Në lidhje me vendosjen e qendrave të votimit brenda objekteve të përzgjedhura, rezultoi se 73% e qendrave të vëzhguara (n=92) ishin të vendosura në katet e para (përdhe) të ndërtesave; 23.8% (n=30) e tyre në katet e dyta dhe 3.2% (n=4) në katet e treta. Shih figurën 2.

Figura 2. Vendosja e qendrave të votimit në nivele të ndryshme katesh



Rezultatet treguan se më shumë se gjysma e ambienteve që u përdorën si qendra votimi, 49.2% (n=62) ishin objekte me hyrje të papërshtatura, me shkallë dhe pa rampa ose të vendosura në kate të dyta e treta të godinave. Shih figurën 3.

Figura 3. Niveli i aksesit në hyrje të qendrave të votimit



Në 22.1% (n=27) të qendrave të votimit në të dhjetë qytetet, u vërejt mungesa e dhomave të fshehta, të përshtatura për përdoruesit e karrigeve me rrota.

30.2% e qendrave të vrojtura (n=35) nuk ishin të pajisura me fletën e posaçme të votimit, e cila do të siguronte votimin e drejtpërdrejtë të votuesve me vështirësi në shikim.

Figura 4. Pjesëmarrja në votim e personave me aftësi të kufizuara sipas llojit të aftësisë së kufizuar





Figura 5. Përqindja e votimit në mënyrë të drejtpërdrejtë për kategori të ndryshme të zgjedhësve me aftësi të kufizuara



Vetëm në 27.8% (n=27) e të gjitha qendrave të vëzhguara, zgjedhësit me aftësi të kufizuara që votuan ishin identifikuar më parë në listat e zgjedhësve.

Gjatë procesit të vëzhgimit në 127 qendrat e vëzhguara u evidentua që morën pjesë në votim në total 331 persona me aftësi të kufizuara. Ndër këta persona, 132 ishin me aftësi të kufizuara në lëvizje; 97 me aftësi të kufizuara në shikim; 60 me aftësi të kufizuara në dëgjim dhe 42 me aftësi të kufizuara intelektuale (figura 4).

Në lidhje me mënyrën e votimit të zgjedhësve, rezultoi se në të gjitha qytetet e vëzhguara shumë prej zgjedhësve me aftësi të kufizuara votuan vetë, pa ndihmën e shoqëruesit. Nga zgjedhësit me aftësi të kufizuara fizike që morën pjesë në votime, 41.7% e tyre votuan vetë, pa asistencë; nga ata me probleme shikimi 23% votuan vetë, pa asistencë; ndër ata me aftësi të kufizuara intelektuale, 14.6% e tyre votuan vetë, pa asistencë. Ndërsa zgjedhësit me probleme dëgjimi vetëm në 19.5% të rasteve votuan me praninë e interpretit të gjuhës së shenjave. Shih figurën 5.

Tek të gjitha kategoritë e zgjedhësve me aftësi të kufizuara, vihet re një përqindje e lartë e votimit përmes asistentit: 58.3% e votuesve me aftësi të kufizuara fizike; 77% e atyre me probleme në shikim dhe 85.4% e votuesve me aftësi të kufizuara intelektuale, u asistuan nga ndihmësit e tyre në momentin e votimit. Edhe në këto zgjedhje, nuk u respektua procedura e parashikuar në ligj për votimin me asistencë, pasi për më shumë se gjysmën e zgjedhësve që votuan me asistencë, shoqëruesi nuk plotësoi deklaratën në Librin e Protokolleve të mbledhjeve të KQV (52.4%).


VI. SONDAZHI I KRYER JASHTË QËNDRAVE TË VOTIMIT

Për të siguruar të dhëna për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuar në procesin e votimeve u përdor metoda e vlerësimit bazuar në intervista që u zhvilluan jashtë qendrës së votimit, me votues në 22 qendra votimi të Tiranës, Kamëzës dhe Vlorës.

Pyetjet e drejtuara kërkonin të mblidhnin të dhëna nëse ndonjë pjesëtar i familjeve të tyre nuk kishte marrë pjesë në votime për arsye se: (i) ishte shumë i moshuar e nuk dilte dot nga shtëpia; (ii) ishte me aftësi të kufizuar fizike; (iii) ishte me aftësi të kufizuar të shikimit; (iv) ishte me aftësi të kufizuar të dëgjimit; (v) ishte me aftësi të kufizuara intelektuale; (vi) ishte përkohësisht i sëmurë.

Numri i përgjithshëm i të intervistuarve jashtë qendrave të votimit, fill pas votimit, ishte 172. Nga këta, 131 pjesëmarrës në vëzhgim (76.1%), konfirmuan se në familjet e tyre kishte të paktën një person me të drejtë vote që nuk mundi të votonte për shkak të aftësisë së kufizuar të përhershme apo të përkohëshme ose se ishin shumë të moshuar. Numri i përgjithshëm i personave me aftësi të kufizuar, me të drejtë vote, që

Figura 6. Përqindja e familjeve që kanë persona që nuk kanë mundur të votojnë



nuk mundën të votonin ishte 271, gati 2 persona për cdo familje, në 22 qendra votimi.

Kjo do të thotë se në 131 familje nga Tirana, Kamza e Vlora, ka të paktën një gjysh, një prind, një vëlla, apo një motër, të cilët e kishin të pamundur të votonin (Figura 6).

Rezultatet e vëzhgimit treguan se të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara afatshkurtër përbënin grupin më të madh të atyre që nuk mundën të votojnë (n=206; 76%).

Shifrat më sipër, mund të ndikojnë për të bërë të mundur përcaktimin e numrit të zgjedhësve të cilët kanë nevojë për të votuar në shtëpi. Kjo përpjekje është e rëndësishme, sepse përdorimi i kutive të lëvizshme të votimit, duhet parashikuar dhe duhet të orientojë në ndryshime në ligjin zgjedhor për të mundësuar përdorimin e kutive të lëvizshme të votimit, duke mos i lënë të pashpresë ata që janë fizikisht të pamundur për të shkuar vetë në qendrat publike të votimit.

VII. KONKLUZIONE

Vëzhgimi i procesit të votimit në ditën e zgjedhjeve parlamentare të 25 prillit tregoi disa hapa të vegjël pozitivë që shoqëria po hedh në pranimin dhe vlerësimin e diversitetit në shoqëri. Këtë e shprehu edhe qëndrimi pozitiv (59.5% normal, 33.3% mikprites), i komisioneve në qendrat e votimit ndaj votuesve me aftësi të kufizuara. Kjo edhe për faktin se KQZ kishte përfshirë në modulet e trajnimit të komisionerëve edhe çështje në lidhje me zgjedhësit me aftësi të kufizuara. Ndërkohë që vetëm në 8 komisione rezultoi të kishte raste fyese dhe indiferente, këto jo vetëm në zonat periferike, ku edhe ndërgjegjësimi është më i ulët, por edhe në qendër të kryeqytetit.

Edhe pse Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve ka nxjerrë Udhëzimin nr. 01, datë 05.12.2020, ku në nenin 5 cilësohet që qendrat e votimit duhet të jenë në katet e para të objekteve, përsëri 27% të qendrave të vëzhguara (n=34) ishin të vendosura në katet e sipërme. Kjo zgjidhje diktoi në disa raste situata, ku votues me aftësi të kufizuara, pasi shkuan pranë qendrës së votimit, e cila ishte në kat të dytë, apo të tretë, u kthyen në shtëpi pa votuar.

Rezultatet e vëzhgimit treguan se 49.2% (n=62) e objekteve me qendra votimi ishin të pa aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara, pa rampe kur qendrat ndodhesin në katin e parë dhe me vendosje në kate të dyta apo të treta. Megjithatë, ka një tendencë për ta orientuar këtë problematikë përmes përzgjedhjes së objekteve ku ka rampa të pjerrët si qendra votimi. Gati gjysma e qendrave të votimit të vëzhguara (50.8%, n=64), e kishin rampin e pjerrët për të lehtësuar akomodimin e vëzhguesve, të cilët përdorin karrige me rrota.

Një masë tjetër që KQZ ka ndërmarrë, ishte edhe Vendimi Nr. 33 datë 16,12.2020” Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të Dhomës së Fshehtë që do të përdoret në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, ku përcaktohet standardi për dhomat e fshehtësisë, të posaçme për personat me aftësi të kufizuara. Mungesa e këtyre dhomave të posaçme në 22.1 % të qendrave të votimit tregon se pavarësisht ecurisë pozitive, duhet më shumë vëmendje dhe masa konkrete për ta plotësuar këtë detyrim të drejtpërdrejtë të KQZ.

Fleta e posaçme e votimit për personat e verbër mungoi në gati në një të tretën e qendrave të vëzhguara (30.2%). Në qendrat ku ky mjet u shpërnda, numri nuk ishte në përputhje me zgjedhësit me aftësi të kufizuara me probleme në shikim.

Vetëm në 27.8% të qendrave të votimit të vrojtuar (n=27), u vu re të kishte zgjedhës me aftësi të kufizuara, të cilët kishin arritur të identifikoheshin paraprakisht në listat e votimit, pranë njësive të pushtetit vendor. Kjo tregon një shkallë ndërgjegjësimi të pamjaftueshme të personave me aftësi të kufizuara për t'u vetëidentifikuar, (u njihet personave me aftësi të kufizuara në Kodin Zgjedhor). Megjithatë, përgjegjësi kanë në këtë aspekt edhe njësitë e pushtetit vendor si edhe KQZ, të cilët nuk ndërmorrën përpjekje për të mbledhur informacionin me rishikimin e listave.

Edhe gjatë zgjedhjeve të fundit ishte i pranishëm votimi përmes shoqëruesit për votuesit e kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar. Nëse do i referoheshim zgjedhësve me probleme në lëvizje dhe atyre me probleme shikimi, votimi përmes asistentit diktohej nga mungesa e mjeteve dhe shërbimeve të përshtatura. Zgjedhësit e verbër, votuan në përqindje të lartë me asistencë (77%). Në zgjedhësit me probleme dëgjimi, ku prania e interpretit të gjuhës së shenjave është e domosdoshme për të sqaruar procedurat e votimit dhe duhej të ishte 100%, vetëm 19.5% patën mundësinë e shoqërimit me interpret të gjuhës së shenjave, kryesisht familjarë ose të afërm të tyre. Jo gjithnjë, në rastet e votimit me asistencë u zbatua Kodi Zgjedhor, i cili rekomandon asistentin të plotësojë deklaratën në Librin e Protokolleve të mbledhjeve të KQV (52.4% të asistentëve nuk e plotësuan këtë kusht).

Edhe në këto zgjedhje, votuesve të cilët nuk mundën të lëvizin nga shtëpia për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore apo mungesës së aksesueshmërisë e shërbimeve mbështetëse, nuk iu ofrua mundësia të shprehin vullnetin e tyre përmes votimit të fshehtë, të drejtpërdrejtë e të lirë. Sa më sipër, dikton marrjen e masave urgjente për gjetjen e zgjedhjeve ligjore alternative për kategorinë e votuesve që nuk lëvizin dot nga banesa.

VIII. REKOMANDIME

Rezultatet e vëzhgimit në ditën e votimit për zgjedhjet parlamentare të 25 Prill 2021, në bashkitë Tiranë, Vlorë, Elbasan, Korçë, Durrës, Kamëz, Peshkopi, Pogradec, Sarandë dhe Shkodër diktojnë rekomandime për pjesëmarrje të plotë në votime të zgjedhësve me aftësi të kufizuara, përmes masave për të realizuar aksesin fizik të mjediseve e mjeteve të votimit për zgjedhësit me aftësi të kufizuara, si dhe për shërbime mbështetëse për të siguruar që të gjithë zgjedhësit me aftësi të kufizuara, që kanë vështirësi për të shkuar e për të marrë pjesë në votime, të mund të votojnë në mënyrë të barabartë, të drejtpërdrejtë e të fshehtë.

Rekomandimet në vijim synojnë të ndikojnë në përmirësimin e situatës, duke dhënë orientime për përmirësime, si në drejtim të organizimit të shërbimeve parazgjedhore e zgjedhore për zgjedhësit me aftësi të kufizuara për identifikimin e tyre në lista, të informimit dhe ndërgjegjësimit të tyre për këtë të drejtë, transportin e përshtatur për në qendrat e votimit, përzgjedhjen e QV të përshtatura dhe/ ose përshtatjen e tyre dhe pajisjen me mjete të posaçme votimi si dhe mundësi votimi për zgjedhësit që nuk dalin dot nga shtëpia. Disa rekomandime si me poshte:

- 1** Të parashikohen përmirësime ligjore në Kodin Zgjedhor, për të siguruar pjesëmarrjen në votim të drejtpërdrejtë, të barabartë e të fshehtë për të gjitha kategoritë e zgjedhësve me aftësi të kufizuara. Kjo, përmes përcaktimit të detyrimeve për strukturat përgjegjëse dhe ndarjes së qartë të roleve të tyre.
- 2** Të shfuqizohet dispozita që mohon të drejtën për të votuar të personave me aftësi të kufizuara në sferën e intelektit, pa zotësi juridike për të vepruar, me qëllim për ta përshtatur legjislacionin kombëtar me detyrimet që sjell për Shtetin Shqiptar KDKPAK.
- 3** KQZ duhet të ndër marrë në mënyrë të përhershme, në kohën e duhur, për çdo proces zgjedhor, planifikime buxhetore përmes një fondi të veçantë për zgjedhësit me aftësi të kufizuara, fond i cili mund të përdoret për përshtatjen e qendrave të votimit, për prodhimin e mjeteve për të verbërit si edhe për prodhimin e dhomave të fshehtësisë të përshtatura.

- 4** Njësitë e pushtetit vendor duhet të marrin masa për informim dhe ndërgjegjësim në kohën e duhur në periudhën parazgjedhore, të zgjedhësve me aftësi të kufizuara, që të identifikohen në listat e zgjedhësve, sipas llojit të aftësisë së kufizuar, për të parashikuar për ta dhe për të realizuar, në bashkëpunim me KQZ, transport ditën e votimit, caktimin në qendra votimi të aksesueshme, kërkesën për mjete të posaçme për të verbërit, dhoma të fshehtësisë të aksesueshme.
- 5** Institucionet përgjegjëse - njësitë e pushtetit vendor në bashkëpunim me KQZ, duhet të marrin masa që QV të jenë të gjitha në objekte me hyrje të përshtatura. Për këtë duhet:
- ◆ të planifikohet ndërtimi i rampave në hyrje të objekteve me shkallë, ose të hiqen nga lista objektet me shumë shkallë dhe QV të tyre të vendosen në të tjera objekte të përshtatura;
 - ◆ të zhvendosen të gjitha qendrat e votimit në katet e para (përdhe) të objekteve, ose të paktën, në bazë të informacionit të mbledhur nga njësitë vendore mbi shpërndarjen e vendbanimeve të personave me aftësi të kufizuara, të vendosin me prioritet qendrat ku ata votojnë në katet e poshtme të ndërtesave.
- 6** KQZ të marrë masa në kohën e duhur, në periudhën parazgjedhore për përgatitjen, testimin, botimin dhe shpërndarjen në kohë të mjeteve të posaçme ndihmëse për të verbërit dhe dhomat e fshehtësisë të aksesueshme.
- 7** KQZ të vazhdojë të përfshijë në spotet publicitare informacion të posaçëm për zgjedhësit me aftësi të kufizuara, duke e shoqëruar edhe me gjuhën e shenjave ose me titra dhe duke përcjellë informacionin në mënyrë të thjeshtuar. Me gjuhën e shenjave të shoqërohen edhe të gjitha spotet që KQZ realizon në periudhën parazgjedhore për ndërgjegjësimin e të gjithë zgjedhësve.
- 8** Të shihet me prioritet gjetja e zgjidhjeve alternative, përmes përmirësimeve ligjore, për votimin e zgjedhësve që nuk dalin dot nga shtëpia apo janë të hospitalizuar.

IX. ANEKSET / INSTRUMENTAT

Vëzhgim në ditën e votimit

Qyteti

Numri i Qëndrës së Votimit

Emri i vëzhguesit

Orët e qëndrimit në QV

nga ora

në orën

1 Qëndrimi i anëtarëve të komisionit të votimit ndaj votuesve me aftësi të kufizuara (përdorues karrigeje me rrota, të verber, me probleme dëgjimi, me probleme mendore) ishte:

- Normal
- Fyes
- Kundërshtues
- Indiferent
- Mikpritës / lehtësues

Komento _____

2 Në cilin kat të ndërtesës ishte vendosur qendra e votimit?

KI

KII

KIII

3 Si ishte hyrja për në qendrën e votimit:

JO PO

Kishte vetëm shkallë

Ishte e përshtatur / e sheshtë ose kishte rampe të pjerrët

3.1 Nëse ishte hyrje e papërshtatur, a kishte vendosur njësi vendore personel ndihmës për zgjedhësit me aftësi të kufizuara?

JO PO

4 A kishte dhomë të fshehtë të përshtatur për zgjedhësit përdorues të karriges me rrota?

JO PO

4.1 A e siguronte pozicioni i kësaj dhome brenda qendrës së votimit fshehtësinë e votës?

JO PO

5 A kishte Qendra e Votimit mjet të posacëm për votimin e të verbërve?

JO PO

Nëse vëzhgohet direkt një votues me aftësi të kufizuara:

6 A ishte identifikuar ai si person me aftësi të kufizuara në listat e votimit ?

JO PO

Pyetjet në vijim plotësohen në orët e fundit të ditës së votimit

7 A kishte votues me aftësi të kufizuara në lëvizje (përdorues të karrigës me rrota, me paterica, etj) që morën pjesë në votim dhe votuan :

	JO	PO	SA
vetë, në mënyrë të drejtpërdrejtë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
nëpërmjet shoqëruesit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

8 A kishte votues të verbër që morën pjesë në votim dhe votuan:

	JO	PO	SA
vetë, në mënyrë të drejtpërdrejtë (me mjete të posacme)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
nëpërmjet shoqëruesit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

9 A kishte votues me probleme dëgjimi që morën pjesë në votim dhe votuan:

	JO	PO	SA
vetë, në mënyrë të drejtpërdrejtë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
u lehtësuan nga përkthyesi i gjuhës së shenjave	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

10 A kishte votues me aftësi të kufizuara intelektuale që morën pjesë në votim dhe votuan:

	JO	PO	SA
vetë, në mënyrë të drejtpërdrejtë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
nëpërmjet shoqëruesit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

11 Nëse zgjedhësit kanë votuar nëpërmjet shoqëruesit, a ka plotësuar shoqëruesi deklaratën në Librin e Protokolleve të Mbledhjeve të KQV?

JO	PO
<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

12 A ndihmuan anëtarët e KQV dhe sekretari zgjedhësit me aftësi të kufizuara?

JO

PO

SA

Komente

PYETESOR

Jashtë qendrës së votimit

PJESEMARRJA E PERSONAVE ME AFTESI TE KUFIZUAR NE PROCESIN E VOTIMEVE

1 A ka ndonjë pjesëtar të familjes tuaj që nuk ka marrë pjesë në votime për arsye se:

	JO	PO	SA
Eshtë shumë e/i moshuar e nuk del fare nga shtëpia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Eshtë me aftësi të kufizuar në lëvizje dhe nuk shkon dot në qendren e votimit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Eshtë me aftësi të kufizuar në shikim	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Eshtë me aftësi të kufizuar të dëgjimit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Eshtë me aftësi të kufizuar intelektuale	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Eshtë përkohësisht i sëmurë	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>